



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 454/1 Prot.

Tiranë, më 19.03.2026

**V E N D I M**

**Nr. 56, datë 19. 03. 2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup> mori në shqyrtim ankesën nr. 61 Regj., datë 26.02.2026, të shtetasit A. M., kundër: Stafit pedagogjik të shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Tiranë, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijës të tij të mitur, O. M., për shkak të “çdo shkak tjetër<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, shtetasi Andi Metani, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur, si më poshtë vijon: *Unë, A. M., në cilësinë e prindit të nxënësit O. M., paraqes këtë ankesë shtesë lidhur me vazhdimësinë e trajtimit diskriminues ndaj djalit tim nga stafi i shkollës Shkolla “Ardian Klosi”.*

*Ju bëj me dije se më parë kam paraqitur tre ankesa pranë institucionit tuaj dhe janë zhvilluar dy seanca dëgjimore lidhur me këtë çështje. Pavarësisht këtyre procedurave dhe ndërhyrjeve institucionale, situata diskriminuese ndaj djalit tim jo vetëm që nuk ka pushuar, por është përkeqësuar.*

*Së fundmi, në sjelljet diskriminuese janë përfshirë edhe mësuese të tjera të stafit pedagogjik, të cilat kanë vijuar me akuza të pabazuara, trajtim të pabarabartë dhe qëndrime provokuese ndaj djalit tim, duke ndikuar negativisht në gjendjen e tij emocionale dhe psikologjike.*

*Këto veprime kanë krijuar një mjedis arsimor të pasigurt, stresues dhe diskriminues për fëmijën tim, pavarësisht procedurave të zhvilluara pranë institucionit tuaj dhe detyrimeve ligjore për garantimin e trajtimit të barabartë në arsim. Në këto kushte, kërkoj nga institucioni juaj:*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

<sup>2</sup> Për shkak të ankesave të paraqitura pranë Komisionerit, kundër shkollës dhe ZVAP Tiranë.

*Rishqyrtimin me përparësi të situatës aktuale dhe të provave të reja. Verifikimin e vazhdimësisë së diskriminimit pas seancave dëgjimore të zhvilluara. Marrjen e masave konkrete dhe efektive për ndalimin e menjëhershëm të çdo forme diskriminimi ndaj djalit tim. Informim zyrtar me shkrim për veprimet dhe vendimmarrjen tuaj.*

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri:

1. Kërkoj të bashkohen të gjitha ankesat që kam disponuar kundër shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, pasi kanë kontekst me njëra-tjetrën.
2. Konstatimin e diskriminimit “për çdo shkak tjetër”.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

*Nga këqyrja e analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:*

- *Me Njoftimin me nr. Prot., 2 të Komisionit të Eikës dhe Sjelljes, të shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Tiranë, drejtuar prindrit A. M., ka njoftuar se në datën 11.02.2026 do të zhvillohet një takim me objekt trajtimin e ankesës së mësuese Z. R., për nxënësin e klasës së VIII, O.M., me qëllim sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe dëgjimin e palëve.*
- *Me shkresën nr.635 prot., datë 18.02.2026 rezulton që z. M. ka bërë ankesë në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, lidhur me stafin pedagogjik të shkollës 9-vjeçare “Ardian Klosi”, Tiranë.*
- *Në datën 20.02.2026 nga Sistemi SMIP, rezulton se prindëri është njoftuar nga mësuesja kujdestare P.K., e nxënësit O.M., lidhur me disa situata problematike të pretenduara të shkaktuara në klasë nga ky nxënës.*
- *Më email e datës 24.02.2026 ankuesi rezulton që i është drejtuar drejtorisë së shkollës me objekt “Ankesë për mësuesen kujdestare P.K.”*
- *Regjistrim audio ku janë incizuar biseda me mësuesen kujdestare dhe një prind të tjetër, ku diskutohet për një situatë dhune të shkaktuar nga nxënësi O.M.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë<sup>3</sup>”*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së,

<sup>3</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi respektivisht edhe për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim,

por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Së pari, në lidhje me kërkesën për bashkimin e ankesave, të cilat përbëjnë gjë të gjykuar apo janë objekt gjykimi aktual nga Komisioneri, parashtrohet se:

Në rastet kur për të njëjtat fakte dhe prova është marrë një vendim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, jemi përpara parimit të “gjësë së gjykuar” në kuptimin administrativ, dhe në përputhje me nenin 33, pika 4, shkronja “c” të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, sipas të cilit ankesa nuk pranohet nëse për të njëjtën çështje është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk paraqiten të dhëna të reja. Ky parashikim lidhet drejtpërdrejt me parimin e sigurisë juridike dhe të stabilitetit të vendimmarrjes administrative, të sanksionuar edhe në Kodin e Procedurave Administrative, i cili ndalon rishqyrtimin e një çështjeje të përfunduar, për sa kohë nuk ekzistojnë rrethana të reja thelbësore. Në këto kushte, mjeti juridik i ankuesit ndaj një vendimi përfundimtar është ankimi në gjykatën kompetente administrative, dhe jo rihapja apo bashkimi i së njëjtës çështje në një procedurë të re administrative.

Për ankesat që aktualisht janë në shqyrtim pranë Komisionerit, edhe nëse palët mund të jenë të njëjta, rezulton se ato i referohen situatave konkrete të ndryshme, me rrethana faktike dhe pretendime të veçanta. Referuar nenit 33, pika 7/3 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, bashkimi i ankesave lejohet vetëm kur ato drejtohen ndaj të njëjtit subjekt dhe kanë të njëjtin objekt. Kushti është kumulativ, që do të thotë se duhet të ekzistojnë njëkohësisht dy elemente: i njëjti subjekt (pra i njëjti person apo institucion ndaj të cilit drejtohet ankesa) dhe i njëjti objekt (*pra e njëjta situatë faktike dhe i njëjti pretendim juridik*). Nëse mungon qoftë edhe njëri prej këtyre elementeve, bashkimi i ankesave nuk lejohet.

Në mungesë të këtij identiteti të plotë, bashkimi procedural do të krijonte paqartësi mbi çështjen konkrete që po shqyrtohet, do të përzierte situata të ndryshme faktike në një procedurë të vetme dhe do të binte në kundërshtim me parimin e individualizimit të procedurës administrative, sipas të cilit çdo ankesë duhet të shqyrtohet më vete, mbi bazën e rrethanave dhe provave specifike që e karakterizojnë atë.

Së dyti, në lidhje me pretendimin për diskriminim, referuar rrethanave të paraqitura dhe dokumentacionit përkatës, vlerësohet sa vijon:

Nga aktet rezulton se Komisioni i Etikës dhe Sjelljes ka njoftuar prindin për zhvillimin e një takimi me objekt shqyrtimin e ankesës së një mësueseje ndaj nxënësit, me qëllim sqarimin e rrethanave dhe dëgjimin e palëve. Po ashtu, evidentohet komunikim nga mësuesja kujdestare lidhur me situata problematike të pretenduara në klasë, si dhe ushtrimi i së drejtës së prindit për t’iu drejtuar drejtorisë së shkollës me ankesë. Këto veprime, në vetvete, përbëjnë ushtrim të funksioneve administrative dhe pedagogjike të institucionit arsimor.

Referuar nenit 54 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, drejtori është përgjegjës për drejtimin e institucionit dhe për

zbatimin e legjislacionit në fuqi. Në këtë kuadër, ai ka kompetencë të sigurojë funksionimin e strukturave të brendshme, përfshirë Komisionin e Etikës dhe Sjelljes, si dhe të garantojë trajtimin e çdo situatë që lidhet me disiplinën, sigurinë dhe mbarëvajtjen e procesit arsimor.

Në të njëjtën linjë, neni 56 dhe neni 67 i Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare (miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020) përcaktojnë qartë se mësuesi dhe mësuesi kujdestar kanë detyrimin të trajtojnë nxënësit me respekt dhe dinjitet, por njëkohësisht të monitorojnë sjelljen e tyre, të evidentojnë problematikat dhe të informojnë rregullisht prindërit, veçanërisht në rastet e sjelljeve shqetësuese apo vështirësive në të nxënë. Informimi i prindit, thirrja në takim, si dhe referimi i çështjes në strukturat përkatëse të shkollës, janë veprime që burojnë drejtpërdrejt nga këto detyrime ligjore dhe nuk përbëjnë, në vetvete, trajtim të pabarabartë apo diskriminues.

Gjithashtu, kuadri ligjor i sipërcituar i njeh institucionit arsimor kompetencën për të kryer verifikimet e nevojshme lidhur me sjelljet e nxënësve, për të mbledhur informacion, për të dëgjuar palët dhe për të marrë masa edukative apo disiplinore proporcionale, në përputhje me rregulloren e brendshme dhe legjislacionin në fuqi. Këto janë funksione tipike të administrimit shkollor dhe përbëjnë ushtrim të autoritetit ligjor të institucionit, me qëllim garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të rregullt për të gjithë nxënësit.

Për sa kohë drejtoria, mësuesit dhe mësuesi kujdestar veprojnë në përputhje me ligjin nr. 69/2012, të ndryshuar, aktet nënligjore përkatëse dhe rregulloren e brendshme të institucionit, duke respektuar procedurat, duke njoftuar prindin dhe duke i dhënë mundësi dëgjimi, veprimet e tyre konsiderohen ushtrim i ligjshëm i kompetencave. Në këtë kuptim, bashkëpunimi aktiv dhe konstruktiv i prindit me institucionin arsimor është një element thelbësor i procesit edukativ, ndërsa qëndrimet apriori dyshuese ndaj çdo veprimi administrativ të shkollës nuk përputhen me frymën e bashkëpunimit të parashikuar në nenin 62 të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar.

Nga një vlerësim i përgjithshëm juridik i rrethanave të paraqitura, rezulton se pretendimi për trajtim diskriminues është i pambështetur në prova apo indicie që do të mund të krijojnë një bazë objektive për konstatimin e diskriminimit. Veprimet e evidentuara lidhen me administrimin e një situatë konkrete disiplinore dhe me përmbushjen e detyrimeve funksionale të shkollës dhe stafit pedagogjik, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Nga shqyrtimi i materialit të paraqitur në rastin konkret, rezulton se ankuesi nuk ka ofruar prova konkrete apo indicie që të krijojnë një prezumim të arsyeshëm se veprimet e ndërmarrë nga shkolla 9-vjeçare “Ardian Klosi”, trajtimi i nxënësit O.M., apo komunikimet dhe procedurat e zhvilluara ndaj tij, kanë pasur karakter diskriminues. Nga dokumentacioni rezulton se nuk ekziston asnjë akt zyrtar, shkresë apo vendim i institucionit që të provojë se ndaj nxënësit është ndërmarrë ndonjë masë disiplinore, është cënuar ndonjë e drejtë e garantuar ligjore, apo është kryer ndonjë procedurë administrative me pasoja negative.

Në lidhje me çdo pretendim për dhunë midis nxënësve, sjellje të papërshtatshme ose vepra penale të mundshme nga nxënësit, këto duhet t'i drejtohen menjëherë organeve kompetente ligjzbatuese, përfshirë Policinë e Shtetit. Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se hetimi i

veprimeve, për të cilat ka dyshime të arsyeshme se mund të përbëjnë elementë të një vepre penale ose kundravajtjeje penale, nuk bën pjesë në kompetencën e tij dhe nuk mund të kryhet nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës me nr. 61 Regj., datë 26.02.2026, të subjektit ankues A. M., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**